



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 21/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Nenad Lazic, Rafet Haxhaj, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me apelin e Koalicionit Stranke Demokratske Akcije dhe Boshnjaqka Stranka Demokratske Akcije Kosova (SDA-BSDAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me nr. 769-2017 të datës 29.05.2017, të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 31.05.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si i pabazuar**, apeli, Anr.21 /2017 datë 30.05.2017, i Koalicionit SDA-BSDAK paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve shqiptar për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

**PZAP-i**, ka pranuar një apel nga Koalicionit SDA-BSDAK me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, me të cilin vendim sipas parashtruesit të apelit janë larguar nga lista 10 kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të koalicionit SDA-BSDAK, për shkak se janë të etnisë shqiptare.

Parashtruesi i apelit, ka theksuar se me vendimin e ankimuar të KQZ-së, nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, ka vepruar në kundërshtim me praktikën zgjedhore, sepse KQZ-ja nuk e arsyeton se mbi çfarë baze është marr vendim i lartpërmendur, nga kjo rezulton sipas parashtruesit të apelit se vendim i ankimuar është marr në kundërshtim me ligjin, duke i tërhequr 10 kandidatë për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga lista e subjektit politik pa vullnetin e tyre. Mëtej parashtruesi i apelit ka theksuar se vendimi ankimuar i KQZ-së, është edhe anti-kushtetues me të cilin cenohen të drejtat elementare të qytetarëve të Kosovës. Me propozim për PZAP-in, që të anulohet vendimi i ankimuar i KQZ-së, dhe të certifikohet lista e SDA-BSDAK, me 30 kandidatët.

PZAP-i, pas pranimi të përgjigjes me nr. të protokollit 777/2017, të kërkuar nga KQZ-ja, brenda afatit të caktuar, me të cilën theksohet se pas shqyrtimit të ankesës së koalicionit SDA-BSDAK e parashtruar nga kryesuesi i përbashkët i koalicionit, qëndron në arsyet e refuzimit sepse koalicioni garon për vendet e garantuara sipas nenit 64 të Kushtetutës së Kosovës dhe sipas nenit 111 paragrafi.1 pika b) të LPZ-së përfshirja e 10 kandidatëve është në kundërshtim me Kushtetutën, gjithashtu iu është bërë me dije se aplikacioni i kërkesës për certifikim në të cilën subjektet politike kanë deklaruar se garojnë për vendet e garantuar e njëjta duhet ti propozohet në listë kandidatët e komunitetit për të cilin garon në zgjedhje në përputhje me vendimin e KQZ zyra ka njoftuar subjektet politike me datën 11 maj për

përmirësimin dhe korrigjimin nga data 17 deri me 22 maj 2017 dhe me datën 23 maj zyra ka rekomanduar KQZ që të bëjë certifikimin e subjekteve politike dhe listës së kandidatëve për deputet për përkatësin shqiptare ndërsa subjektet politike të komunitetit jo shumicë i ka certifikuar po me të njëjtën datë por për listat e kandidatëve ka kërkuar që të verifikohet përkatësia e tyre etnike në Agjencionin e Regjistrimit Civil dhe pas vlerësimit ARC i ka kthyer përgjigje Zyrës se 4 kandidatë nga lista e subjektit politik koalicionit janë pjesëtar të përkatësisë shqiptare. Andaj çdo vendim ndryshe nga KQZ do të krijonte praktik jo të mirë në zgjedhje dhe do të cenonte Kushtetutën e Republikës së Kosovës nën 64 dhe do të rrezikonte procesin zgjedhor sidomos në këtë fazë ku kanë filluar prodhimet e të gjitha materialeve zgjedhore si dhe broshurat e kandidatëve të certifikuar.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe Vendimin e KQZ-së, Nr. 769/2017 të datës 29.05.2017.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pohimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), **refuzoj si të pabazuar apelin** dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi nga arsyet në vijim:

Nga vendimi i KQZ-së, Nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, paneli konstaton se është certifikuar lista e 20 kandidatëve për deputet e koalicionit SDA-BSDAK, që garojnë për vendet e garantuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe janë refuzuar 10 kandidat të te njëjtës listë ngase subjekti i lartpërmendur politik garon në zgjedhjet e datës 11.06.2017, për vendet e garantuara për minoritete në Kuvendin e Kosovës.

Paneli i PZAP-it, vlerëson ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, Nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, dhe konstaton se i njëjti është në harmoni të plotë me nenin 111 par.1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:*

*a) njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe*

*b) njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:*

*(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); (ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”.*

Prandaj paneli konsideron se në momentin kur një subjekt politik që garon në zgjedhje, për vendet e garantuar, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe nëse subjekti

politik dëshiron të garoj për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës, është i njoftuar paraprakisht, me dispozitën e lart cituar ligjore dhe poashtu në këtë rast është njoftuar nga KQZ me procedurën e aplikimit për regjistrim-certifikim, te cilën e potencon vetë udhëheqësi i koalicioni SDA-BSDAK, se ka qenë i njoftuar me procedurën, në seancën e datës 26.05.2017, sepse rrjedhimisht kandidatët në listën e subjektit politik do të duhej të deklarohen me rastin e aplikimit për certifikim se garojnë për vendet e garantuar dhe duhet të jenë nga komuniteti jo shqiptar, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë koalicioni SDA-BSDAK, që garon në zgjedhjet e datës 11.06.2017, për vendet e garantuara, për komunitetet jo shumicë në Kosovë.

Mbi këtë bazë paneli vlerësoi se KQZ me vendimin Nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, drejt ka vepruar me rastin e largimit të kandidatëve shqiptar nga lista e koalicioni SDA-BSDAK, pasi që koalicioni SDA-BSDAK, garon në Kuvendin e Kosovës për zgjedhjet e datës 11.06.2017, për vendet e garantuar, të cilat vendet si me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu edhe me nenin 111 par. 1 të LZP-së, janë vende ekskluzivisht të rezervuara-garantuara për komunitet në Republikën e Kosovës, jo për komunitetin shqiptar, për këtë arsye dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, te gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje për Kuvend të Republikës së Kosovës, për vendet e garantuara do të duhej që në listat e tyre për kandidat, për deputet të jenë vetëm nga komuniteti që i për këtë subjekti politik, jo nga komuniteti shqiptar, që në rastin konkret koalicioni SDA-BSDAK, nuk ka vepruar konform dispozitave të lartë theksuara dhe procedurave për aplikim të një subjekti politik që garon në zgjedhje për vendet e garantuar në Kuvend të Republikës së Kosovës, ku në mesin e kandidatëve për deputet ka propozuar për certifikim në KQZ edhe kandidat për deputet nga komunitetit shumicë-shqiptar në vend, i cili fakt nuk është kontestuar me pretendimet ankimore, se kandidatët e refuzuar për certifikim i përkasin komunitetit shumicë.


Paneli ka vlerësuar pretendimet me apel, por vlerëson se të njëjtat nuk paraqesin referencë për marrjen e vendimit më të favorshëm për apellesit. Edhe për kundër faktit se askujt nuk mund që t'i mohohet e drejta për t'u zgjedhur gjegjësisht për të qenë kandidat në listat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Paneli gjen se përfshirja në listat e kandidimit për vendet e garantuara të pjesëtareve të komunitetit shumicë, cenon nenin 64 par 2, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me vendet e garantuara. Sipas Kushtetutës këto vende të garantuara janë parashikuar ekskluzivisht për komunitetet jo shumicë, e të cilit komunitet në rastin konkret i takon edhe parashtruesi i apelit.

Andaj, nga arsyet e lart theksuara konform nenit 118 par. 1 dhe nenit 122 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 21/2017 më datën 31.05.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Ymer Hoxha



**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.